

**KOMBET E  
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen  
Penale të Personave Përgjegjës për  
Shkelje të Rënda të së Drejtës  
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera  
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej  
Vitit 1991

Lënda Nr.: IT-04-84-A

Data: 3 mars 2009

Originali: anglisht

**PARA GJYKATËSIT PARAAPELUES**

**Para:** Gjykatësit Fausto Pocar, Gjykatës Paraapelues

**Ushtruesi i Detyrës  
së Sekretarit:** Z. John Hocking

**Urdhëresë e datës:** 3 mars 2009

**PROKURORI**

**kundër**

**RAMUSH HARADINAJT  
IDRIZ BALAJT  
LAHI BRAHIMAJT**

**PUBLIKE**

**URDHËRESE PËR CAKTIM DATE**

**Zyrës së Prokurorit:**

Z. Serge Brammertz

**Avokatëve për të Akuzuarit:**

Z. Ben Emmerson QC, Z. Rodney Dixon dhe Zj. Susan L. Park për Ramush Haradinajn  
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn  
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

**UNË, FAUSTO POCAR**, Gjykatës i Dhomës së Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991 ("Tribunali") dhe Gjykatës Paraapelues në këtë çështje;<sup>1</sup>

**DUKE MARRË PARASYSH** se Rregulla 65*bis*(B) e Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit Ndërkombëtar ("Rregulloja") kërkon mbajtjen e një konference për gjendjen brenda njëqindnjëzet ditëve pas dorëzimit të njoftimit për apel dhe më pas brenda njëqindnjëzet ditëve pas konferencës së fundit për gjendjen, për t'i mundësuar çdo personi të paraburgosur në pritje të apelit të ngrejë çështje në lidhje me të, ndër të tjera edhe gjendjen fizike dhe mendore të atij personi;

**DUKE MARRË PARASYSH** se konferenca e fundit për gjendjen në këtë çështje u mbajt më 24 nëntor 2008;

**BAZUAR** në Rregullën 65*bis*(B) të Rregullores;

**URDHËROJ** që në praninë time të mbahet një konferencë për gjendjen, të mërkurën, më 11 mars 2009, në orën 17:30, në Sallën Gjyqësore I.

Bërë në anglisht dhe frengjisht. Teksti në anglisht ka përparësi.

Sot, më datën 3 mars 2009

Në Hagë  
Holandë

/nënshkruar në origjinal/  
Gjykatësi Fausto Pocar  
Gjykatës Paraapelues

/vula e Tribunalit/

<sup>1</sup> Urdhër që Cakton Gjykatësit e një Çështjeje në Dhomën e Apelit dhe Emëron Gjykatësin Paraapelues, 6 maj 2008.